



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 maj 2014
Nr.ref.:VTK631/14

VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin Nr. KI223/13

Parashtrues

Xhafer Murati

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar
të autoritetit publik**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar

Ivan Čukalović, zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Xhafer Murati nga Podujeva.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon se cilin vendim të autoritetit publik e konteston, edhe pse ai pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me ligj dhe me Kushtetutë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është realizimi i së drejtës së pretenduar në 20% nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”). Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet shkeljes së ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 10 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI223/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI223/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Almiro Rodrigues.
7. Më 27 janar 2014, Gjykata me shkresën [nr. ref: 118/14], e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatën Kushtetuese vendimet relevante të autoriteteve publike.
8. Nga parashtruesi nuk u pranua asnjë përgjigje.
9. Më 2 prill 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 10 dhjetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke shfrytëzuar *“formularin për parashtrimin e kërkesës”*. Sa i përket përshkrimin të fakteve, ai vetëm theksoi *“se dëshiron t’i paguhet 20% nga shitja e NSH “Ramiz Sadiku”*. Lidhur me arsyetimin e kërkesës dhe shkeljet e pretenduara të Kushtetutës, ai vetëm theksoi: *“Nuk kam njohuri rreth saktësisë së neneve kushtetuese, mirëpo besoj që më është shkelur e drejta në punë, sepse edhe në Kushtetutë janë të qartësuara të drejtat e punëtorit dhe të garantuara me Ligj”*. Përfundimisht, parashtruesi në pasqyrën e zgjidhjes së kërkuar, ka

shkruar vetëm “Dëshiroj që t’më realizohet e drejta ime rreth 20% që mua më takon si ish-punëtor i firmës “Ramiz Sadiku”.

11. Parashtruesi i kërkesës ka bashkëngjitur: Aktvendimin e pranimi në marrëdhënie të punës, regjistrin e sigurimit, Aktvendimin e të ardhurave personale, Aktvendimin e ndërmarrjes “Ramiz Sadiku” dhe certifikatën e rregullimit të obligimit ushtarak.
12. Më 27 janar 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës ta kompletojë dhe ta sqarojë kërkesën. Në njoftim, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar se nëse nuk i ofron dokumentet e kërkuara, Gjykata nuk do të jetë në gjendje ta shqyrtojë kërkesën.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi pretendon se:

“Kërkojë 20% e pagës që firma ‘Ramiz Sadiku’ nuk mi ka dhënë me pretekstin që është përmbyll afati për t’i dorëzuar dokumentet, mirëpo, sipas mendimit tim afati ka qenë mjaft i shkurtër dhe unë kam qenë jashtë vendit dhe nuk kam mujt mi dorëzuar”.

14. Parashtruesi më tej pretendon se:

“Nuk kam njohuri rreth saktësisë së neneve kushtetuese, mirëpo besoj që më është shkelur e drejta në punë, sepse edhe në Kushtetutë janë të qartësuara të drejtat e punëtorit dhe të garantuara me Ligj”.

15. Parashtruesi kërkon nga Gjykata:

“Dëshiroj që t’më realizohet e drejta ime rreth 20% që mua më takon si ish-punëtor i firmës ‘Ramiz Sadiku’, sepse ish-kolegët e mij kanë marrë, mirëpo mua as që më kanë marrë parasysish rreth këti 20%, prandaj kërkoj me shumë mirëkuptim që edhe mua t’më realizohet kjo e drejt dhe ankesa ime të aprovohet nga ju”.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113,7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Gjykata gjithashtu thirret në nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

19. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 29 (2) [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(…)

(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor, nëse ka; (d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës”.

(3) Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e çfarëdo dokumenti relevant për të mbështetur atë. Nëse vetëm disa pjesë të dokumentit janë të rëndësishme, atëherë, sipas nevojës, duhet të bashkëngjiten vetëm pjesët e tilla”.

20. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest”.

21. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka siguruar dhe dorëzuar ndonjë informatë dhe dokumente që tregojnë se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur nga autoriteti publik; çfarë ishte procedura e shterimit të mjeteve juridike dhe cilat janë pretendimet kryesore dhe në çfarë baze janë mbështetur.
22. Gjykata vëren më tej se e ashtuquajtura kërkesë paraqitet në formularin e kërkesës të miratuar nga Gjykata për ankesa kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese nga autoritetet publike. Megjithatë, kërkesa nuk ofron informata përkatëse dhe dëshmi relevante, në mënyrë që Gjykata të vlerësojë kriteret e pranueshmërisë.
23. Kriteret e pranueshmërisë janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të saktësuara më tej në Rregulloren e punës, siç përcaktohet më lart.
24. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të saktësojë se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe cilin akt të autoritetit publik ai e konteston. Në të vërtetë, ai nuk ka ofruar informata dhe shpjegim në lidhje me shkeljet e të drejtave, të garantuara me Kushtetutë, dhe as aktin e një autoriteti publik që është objekt i vlerësimit.
25. Për më tepër, parashtruesi as nuk e ka dëshmuar rastin, në të cilin veten e konsideron viktimë të shkeljes së Kushtetutës (shih *Scordino kundër Italisë* (nr. 1) [DHM], § 179), dhe as nuk ka dorëzuar informata të nevojshme përcjellëse dhe dokumente.

26. Në të vërtetë, procedurat në Gjykatën Kushtetuese janë në kundërshtim për nga natyra. Nga parashtruesi varet mbështetja me argumente faktike (duke i dhënë Gjykatës argumentet e nevojshme faktike), si dhe argumentet juridike (që shpjegojnë se pse dhe si, sipas mendimit të tij, janë shkelur dispozitat e Kushtetutës). Gjykata është përgjegjëse për vërtetimin e fakteve, dhe nga parashtruesi varet ofrimi i ndihmës aktive, duke siguruar të dhënat e nevojshme dhe dokumentet përkatëse.
27. Duke pasur parasysh atë që u cek më lart, nuk është çështje e Gjykatës që ta ndërtojë rastin në emër të parashtruesit. Përkundrazi, kjo duhet të bëhet nga vetë parashtruesi, i cili duhet t'i drejtohet Gjykatës në përputhje me të gjitha kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.
28. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës është i obliguar t'i shterojë të gjitha mjetet juridike, të parapara me ligj, siç parashihet me nenin 113.7. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli i shterimit është i ndërthurur në mënyrë funksionale me karakterin e subsidiaritetit të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, *Selmouni kundër Francës* [DHM], § 74; *Kudla kundër Polonisë* [DHM], § 152; *Andrashik dhe të tjerët kundër Sllovakisë* [dec.]).
29. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, qoftë administrative apo gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore.
30. Në rastin konkret, parashtruesi nuk ka dëshmuar se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, të parapara me sistemin e rregullt juridik.
31. Gjykata rikujton se parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar një shkresë, ku paralajmërohet se nëse nuk i ofron informatat dhe dokumentet e kërkuara, Gjykata nuk do të jetë në gjendje ta shqyrtojë kërkesën. Gjykata më tej thekson se parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur kësaj shkrese.
32. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e lartpërmendur nuk e kalon pragun minimal që të konsiderohet kërkesë, me të cilën rasti i përmendur do të duhej të ngrihej. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se është legjitime të supozohet se parashtruesi i kërkesës nuk është i interesuar për procedim të mëtejshëm të rastit.
33. Për më tepër, mënyra se si është parashtruar kërkesa, mund të shihet, në qasje të rreptë, si abuzim i së drejtës për t'u ankuar. Gjykata është e detyruar me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili parashihet: "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".
34. Në të vërtetë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton se "*çdo sjellje e parashtruesit të kërkesës e cila është qartazi në kundërshtim me*

qëllimin e të drejtës së kërkesës individuale, siç parashihet në Konventë, dhe që e pengon funksionimin e mirëfilltë të Gjykatës apo zhvillimin e mirëfilltë të procedurës para saj përbën abuzim të së drejtës së kërkesës" (shih Mirolubovs dhe të tjerët kundër Lituanië, paragrafët 62 dhe 65).

35. Megjithatë, Gjykata mendon që në këtë fazë nuk këshillohet të miratohet një qasje e rreptë e tillë; megjithatë, është me rëndësi që parashtruesi ta dijë këtë, pasi duket që ai e ka keqkuptuar rolin e Gjykatës Kushtetuese dhe natyrën e kornizës së punës së drejtësisë kushtetuese, siç përcaktohet në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregulloren e punës.
36. Gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë, Gjykata arriti në përfundimin se me rastin e pranimit të dokumenteve të kërkesave të tilla, ku parashtruesi i kërkesës është qartazi palë juridikisht e paditur, këshilltarët ligjor duhet ta udhëzojnë palën në ndihmë profesionale për plotësimin e formularit të kërkesës.
37. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se nuk ka rast apo kontest që duhet të shqyrtohet në kërkesën e lartpërmendur, dhe në përputhje me këtë, nuk ka arsye për procedurë të mëtejme në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës dhe kërkesa duhet të hidhet poshtë.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 prill 2014, njëzëri:

VENDOS

- I. TA HEQË kërkesën nga lista;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani